UDHËZIM
Nr. 10, datë 3.7.2014

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1945, DATË 4.10.2010, PËR ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 617, DATË 7.9.2006, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E TREGUESVE TË VLERËSIMIT DHE TË MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË NDIHMËS EKONOMIKE, TË PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE TË SHËRBIMEVE SHOQËRORE"

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të vendimit nr. 617, datë 7.9.2006, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e treguesve të vlerësimit dhe monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe të shërbimeve shoqërore",

UDHËZOJ:

Në kreun I "Treguesit statistikorë për ndihmën ekonomike dhe pagesën për personat me aftësi të kufizuara që plotësojnë bashkitë/komunat", bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në germën A, "Statistikat për ndihmën ekonomike", pika 1 riformulohet:

Administratori shoqëror mbledh dhe përpunon:

"1. Informacion mbi numrin e familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike me fondet e buxhetit të shtetit, sipas përbërjes së saj me anëtarë, numrin e familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike, të plotë apo të pjesshme. Numrin e familjeve që kanë në përbërjen e tyre persona me aftësi të kufizuara, romë, numrin e familjeve me kryefamiljare gra. Përcakton numrin e individëve që përfitojnë ndihmë ekonomike, si: jetimë, viktima të dhunës në marrëdhëniet familjare, viktima të trafikimit, fëmijë në shërbimin e kujdestarisë, numrin e fëmijëve të lindur si trinjakë, katërnjakë dhe pesënjakë. Numrin e familjeve që përfitojnë kompensim të energjisë elektrike, si edhe shumat e fondeve të shpenzuara për 2-mujorin dhe progresive prej fillimit të vitit për çdo kategori sipas mod. 1, tab. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.".

2. Në germën B, "Statistikat për pagesën për personat me aftësi të kufizuara", pikat 1 dhe 4 riformulohen:

Administratori shoqëror mbledh dhe përpunon informacion mbi:

"1. Numrin e personave me aftësi të kufizuara: për të verbrit, para-tetraplegjikët, personat me aftësi të kufizuara mendore, fizike, si dhe të kujdestarëve për secilin grup së bashku, numrin e personave me aftësi të kufizuara që i përket minoritetit rom. Numrin e para-tetraplegjikëve që përfitojnë një paketë të veçantë higjieno-sanitare. Numrin e personave të verbër dhe numrin e para-tetraplegjikëve që përfitojnë kompensim energjie dhe kompensim të telefonisë fikse, kryefamiljarë të personave me aftësi të kufizuara përfitues të kompensimit të energjisë, si dhe fondin faktik të shpenzuar në lekë për 2-mujorin dhe progresive prej fillimit të vitit për grupet e mësipërme sipas mod. 1, tab. 6, bashkëlidhur këtij udhëzimi.".

4. Numrin e invalidëve të punës që marrin pagesë për aftësinë e kufizuar sipas grup-moshave, gjinisë, llojeve të sëmundshmërisë, grupeve të invaliditetit dhe fondet faktike të shpenzuara për dymujorin, si dhe progresive prej fillimit të vitit sipas mod. 1, tab. 9, bashkëlidhur këtij udhëzimi.".

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Erion Veliaj

Tabela mbi numrin e familjeve, individëve përfitues të skemës së ndihmës ekonomike si dhe fondet faktike të shpenzuara për 2-Mujorin dhe prej fillimit të vitit.

Mod. 1, Tab1

Nr	Emërtimi	Numri I familjeve			Fondi faktik i shpenzuar në leke			Fondi faktik i shpenzuar në leke		
			Nga keto:		2 - mujori			Prej fillimit te vitit		
		Gjithsej	Me Nd. Ek te Plote	Me Nd. Ek te Pjesshme	Gjithsej	Per Nd. Ek te Plote	Per Nd. Ek te Pjesshme	Gjithsej	Per Nd. Ek te Plote	Per Nd. Ek te Pjesshme
A	**Familje gjithsej (1 deri te 7)**									
1	Me 1 Anëtar									
2	Me 2 Anëtar									
3	Me 3 Anëtar									
4	Me 4 Anëtar									
5	Me 5 Anëtar									
6	Me 6 Anëtar									
7	Mbi 6 Anëtar									
	nga keto:									
a	Familje qe kane ne perberjen e tyre persona me AK									
b	Familje qe kane ne perberjen e tyre Rom									
c	Familje qe kane ne perberjen e tyre Kryfamiljare gra									
B	**Individë Gjithsej**									
1	Jetim deri 18 vjec									
2	Jetim mbi 25 vjec									
3	3 njakë e familjeve									
4	4 njakë e familjeve									
5	5 njakë e familjeve									
6	Viktima te Dhunes									
7	Viktima te Trafikimit									
8	Femije gjithsej në sherbim kujdestarie									
9	nga këto: me aftësi të kufizuar									
10	Femije ne sherbim kujdestarie (shpenzime veshje + shpenzime indirekte)									
11	Femije ne sherbim kujdestarie që ndjekin shkollën (shpenzime shkolle)									
C	**Komp Energjie per Familjet ne Skeme**									

ADMINISTRATORI

( )

KRYETARI

( )

PREFEKTURA_____

RRETHI_____ _____ më datë ____/____/_____

BASHKIA/KOMUNA_____

Tabela mbi numrin e e personave me PAK fizik a mendor , të verbër, Paraetetraplegjik sipas grupeve.

Fondet faktike të shpenzuara për 2-Mujorin dhe prej si dhe fillimit të vitit.

Mod. 1, Tab 6

Nr	Emërtimi	Numri Personave PAK	Fondi faktik i shpenzuar në lekë	
			2 - mujori	Prej fillimit të vitit
I	**Paaftë gjithsej (1 + 1.1 + 1.2)**			
1	**Të paaftë gjithsej (a+b+c)**			
a	100%			
b	200%			
c	300%			
	Nga keto : Rom			
1.1	**Kujdestarë gjithsej**			
	100%			
	150%			
1.2	Kryefamiljar me PAK perfitues te Kompesim Energjie .			
II	**Të verbër gjithsej (2 + 2.1 + 2.2 + 2.3)**			
2	**Të verbër gjithsej (a+b+c+d)**			
a	100%			
b	150%			
c	200%			
d	300%			
	Nga keto : Rom			
2.1	**Numri kujdestarëve**			
2.2	**Kompesim Energjie ne total (a+ b)**			
a	Kompesim Energjie Verber me kujdestar			
b	Kompesim Energjie Verber pa kujdestar			
2.3	**Kompesim Telefoni per te Verber**			
III	**Paraetetraplegjik Gjithsej(3+3.1+3.2+3.3+3.4)**			
3	**Paraetetraplegjik gjithsej (a + b + c)**			
a	100%			
b	200%			
c	300%			
	Nga keto : Rom			
3.1	**Kujdestarë gjithsej (a + b)**			
a	100%			
b	150%			
3.2	**Paketa Higjeno sanitare**			
3.3	**Kompesim Energjie ne total (a+b)**			
a	Komp Energjie Paraetetraplegjik me kujdestar			
b	Komp Energjie Paraetetraplegjik pa kujdestar			
3.4	**Kompesim Telefoni per Paraetetraplegjik**			
	Totali (I + II + III)			

ADMINISTRATORI

(_____)

KRYETARI

(_____)

PREFEKTURA _____ _____ më datë __/__/_____

RRETHI _____

Mod.1 – Tab.9

BASHKIA/KOMUNA _____

NUMRI I INVALIDËVE TË PUNËS SIPAS GRUP–MOSHAVE, GJINISW, LLOJIT TË INVALIDITETIT DHE FONDI I SHPËRNDARË

NR	EMËRTIMI	NUMRI INVALIDËVE TË PUNËS	FONDI FAKTIK I SHPENZUAR NË LEKË	
			2 MUJORI	PREJ FILLIMIT TË VITIT
I	INVALIDË PUNE GJITHSEJ (M+F)			
	SIPAS GRUP MOSHAVE MESHKUJ			
A	GJITHSEJ (1+2+3+4+5+6)			
1	Deri në 30 vjeç			
2	31 – 40			
3	41 – 50			
4	51 – 60			
5	60 – 65			
6	MBI 65 VJEÇ			
	SIPAS GRUPMOSHAVE FEMRA			
B	GJITHSEJ (1+2+3+4+5)			
1	Deri në 30 vjeç			
2	31 – 40			
3	41 – 50			
4	51 – 60			
5	MBI 60 VJEÇ			
	SIPAS GRUPEVE TË INVALIDITETIT			
II	GJITHSEJ (1+2+3+4)			
1	A. Sëmundje Përgjithshme Grupi I			
2	B. Sëmundje Përgjithshme Grupi II			
3	C. Sëmundje Profesionale Grupi I			
4	D. Sëmundje Profesionale Grupi II			
5	Nga këta – Pension Pleqërie			

Shënim: Evidenca është e detyrueshme çdo dy muaj brenda datës 10 të muajit pasardhës sipas VKM nr. 617, dt. 7.9.2006

ADMINISTRATORI

(_____)

KRYETARI

(_____)